



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 3, datë 01.03.2012

PËR
"ZMADHIMIN E KAPITALIT TË "KLUBIT TË FUTBOLLIT TIRANA SHA"

Në mbështetje të nenit 8/1/II/"a" dhe "c", të ligjit nr.8652, datë 31.07.2000 për "Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore" (i ndryshuar), nenit 135, 168 dhe 169 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 për "Tregtarët dhe shoqëritë tregtare", nenit 26, 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar); Statutit të Shoqërisë Aksionare "Klubi i Futbollit Tirana" sha; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 14, datë 12.10.2011 për "Transformimin në shoqëri aksionare të Klubit të Futbollit "Tirana", miratimit të aktit të themelimit dhe statutit të shoqërisë aksionare të Klubit të futbollit "Tirana"; vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 25, datë 28.12.2011 për "Miratimin e buxhetit të vitit 2012", me propozimin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Zmadhimin e kapitalit të "Klubit të Futbollit Tirana" sha me vlerën prej 80.000.000 (tetëdhjetë milion) lekë duke nënshkruar 80,000 (tetëdhjetë mijë) aksione të reja, me vlerë nominale prej 1000 (një mijë) lekë.
2. Kapitali i "Klubit të Futbollit Tirana" sha pas zmadhimit do të shkojë nga 6.445.263.000 (gjashtë miliard e katërqind e dyzet e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë që ishte më parë, në 6.525.263.000 (gjashtë miliard e pesëqind e njëzet e pesë milion e dyqind e gjashtëdhjetë e tre mijë) lekë, të ndara në 6.525.263 (gjashtë milion e pesëqind e njëzet e pesë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e tre) aksione.
3. Aksionet do të shlyhen nga Aksionari Bashkia e Tiranës, brenda datës 31.12.2012.
4. Ngarkohet administratori i shoqërisë të ndjekë procedurat ligjore për regjistrimin e vendimit për zmadhimin e kapitalit dhe depozitimin e dokumentacionit përkatës pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
5. Ngarkohen "Klubi i Futbollit Tirana" sha, Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Financës, për zbatimin e këtij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

Niazi KOSOVRASTI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

Nr.prot 2656

Tiranë 3/03 2012

Drejtuar: **Z. Salid Tagani**
Drejtor i Klubit të Futbollit Tirana SHA

Lënda: **Dërgim vendimi**

I nderuar z.Tafari,

Bashkëngjitur, **Ju** dërgojmë Vendimin e miratuar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, të datës 01.03.2012, të konfirmuar nga Prefektura me nr.prot.487/1 date 12.03.2012, si më poshtë:

1. **Vendim nr.3, dt.01.03.2012:** Për "Zmadhimin e kapitalit të "Klubit të Futbollit Tirana S.H.A".

Faleminderit për bashkëpunimin.

Me respekt

Sekretar



Vladimir GJONAJ

Aplikanti : KLUBI I FUTBOLLIT TIRANA SH.A
Përfqaruar nga:
Lerin BURBA



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 18, datë 25.06.2014

**PËR
“NDRYSHIME NË STATUT, KAPITALIN THEMELTAR DHE GJENDJEN JURIDIKE
TË KLUBIT TË FUTBOLLIT “TIRANA”SH.A”**

Në mbështetje të neneve 7 pika 2, 8 pika 1 paragrafi II shkronja "a", "c", paragrafi VI shkronja "a" 10 pika 3 paragrafi II shkronja "b", 32/"d", "e" dhe 44/"b", "c" të Ligjit Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; neneve 18 pika 4, 19 pika 3 të Ligjit Nr. 9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin" (i ndryshuar); neneve 105 e ne vijim të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; neneve 9, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 34 të Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt"; neneve 43, 45 të Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar; Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë; Në bazë të Statutit të Shoqërisë Aksionare Klubit i Futbollit Tirana sh.a; neneve 1, 2 të Ligjit nr. 10340, datë 28.10.2010 "Për Pagesën e Detyrimeve ndaj të Tretëve të Ndërmarrjeve dhe Sh.a-ve në Pronësi të Pushtetit Vendor; ligjit Nr.9228, date 29.4.2004 "Për Kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 1718, datë 24.12.2005 për "Procedurat e transformimit të klubeve sportive në shoqëri aksionare dhe për kriteret e përcaktimit të kapitalit themeltar", me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I :

Për miratimin e bilancit dhe pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2012

1. Të miratohet bilanci dhe pasqyrat financiare të Klubit të Futbollit Tirana sh.a për vitin ushtrimor 2012 dhe njohjen e rezultatit.
2. Shoqëria aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, për vitin ushtrimor 2012 është me humbje.
3. Bashkia e Tiranës nuk do të përfitojë shpërndarje të dividendit për vitin ushtrimor 2012.

Aplikant: Lorin BURDA

Për miratimin e bilancit dhe pasqyrave financiare për vitin ushtrimor 2013

1. Të miratohet bilanci dhe pasqyrat financiare të Klubit të Futbollit Tirana sh.a për vitin ushtrimor 2013 dhe njohja e rezultatit.
2. Shoqëria aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, për vitin ushtrimor 2013 është me humbje.
3. Bashkia e Tiranës nuk do të përfitojë shpërndarje të dividendit për vitin ushtrimor 2013.

Për ndarjen dhe ekzekutimin e debive

1. Në rast të verifikimit të rrethanave të parashikuara në Nenin 6 dhe 7 të këtij vendimi, të gjitha debitë e Klubit të Futbollit Tirana sh.a të pasqyruara bilancet dhe pasqyrat financiare të miratuara në këtë vendim, të cilat janë krijuar dhe maturuar përpara transformimit të Klubit në shoqëri aksionare; gjatë vitit ushtrimor 2011, 2012 dhe 2013 do të shlyhen nga aksionarët egzistues dhe të ardhshëm, në proporcion me kontributin në kapitalin themeltar.
2. Bazuar në Nenin 6 dhe 7 të këtij vendimi, autorizohet Kryetari i Bashkisë të negociojë dhe përfundojë marrëveshje me Klubin e Futbollit Tirana sh.a për shlyerjen e debive egzistuese të shoqërisë tregtare, sipas rishpërndarjes së kontributeve në kapitalin themeltar.
3. Bazuar në pikën 1 dhe 2 të këtij neni, të gjitha subjektet kreditore të Klubit të Futbollit Tirana sh.a, do të konsiderohen kreditor të Bashkisë së Tiranës.
4. Në zbatim të këtij neni, ngarkohet Klubi i Futbollit Tirana sh.a dhe Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit pranë Bashkisë së Tiranës, për krijimin e fondit të posaçëm dhe për përpilimin e grafikëve të ekzekutimit të debive.
5. Ngarkohet Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit dhe Klubi i Futbollit Tirana sh.a për bashkërendimin dhe rakordimin e të dhënave.

Për zvogëlimin e kapitalit themeltar

1. Kapitali themeltar i Klubit të Futbollit Tirana sh.a, në vlerën 6.708.642.668 (gjashtë miliard e shtatëqind e tetë milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) Lek, do të zvogëlohet përmes anulimit të aksioneve të nënshkruara në momentin e transformimit, si rrjedhojë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 14, datë 12.10.2011, sa i përket kontributit në natyrë të aksionarit të vetëm, si vijon:
 - a) Të anulohen aksione në masën e 4.197.661 aksioneve, korresponduese me vlerën e pasurisë së paluajtshme Stadiumi "Selman Stermasi", me Nr. Pasurie 1/155, Z.K. 8270 dhe 1/128, Z.K. 8270, prej 4.197.661.000 Lek, bazuar në raportin e Ekspertit vlerësues, hartuar në momentin e transformimit të Klubit të Futbollit Tirana në shoqëri aksionare;
 - b) Të anulohen aksione në masën e 664.632,87 aksioneve, korresponduese me vlerën e pasurisë së paluajtshme Stadiumi "Skënder Halili", regjistruar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 342, datë 20.06.2005 dhe me Nr. Pasurie 3/118, Z.K. 8240, prej 664.632.870 Lek, bazuar në raportin e Ekspertit vlerësues, hartuar në momentin e transformimit të Klubit të Futbollit Tirana në shoqëri aksionare;

Aplikanti: Lorin BURBA



- c) Të anulohen aksione në masën e 298.200,490 aksioneve, koresponduese me vlerën e pasurisë së paluajtshme "Fusha e Kombinatit", me Nr. 2/85, Z.K. 8230, Indeks harte Tr-S,T, -1,2, prej 298.200.490 Lek, bazuar në raportin e Ekspertit vlerësues, hartuar në momentin e transformimit të Klubit të Futbollit Tirana në shoqëri aksionare.
2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, pasuritë e paluajtshme të përmendura shprehimisht në të do të kthehen në pronësinë e Bashkisë Tiranë. Ngarkohet Drejtoria Juridike për regjistrimin e këtij vendimi në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.
3. Pasuritë e paluajtshme të përmendura shprehimisht në këtë nen, do t'i jepen në përdorim pa kundërshpërblim Klubit të Futbollit Tirana sh.a, për një periudhë 18 vjeçare, me të drejtë investimi.
4. Në zbatim të pikës 3 të këtij neni dhe Nenit 6 dhe 7 të këtij vendimi, investimet dhe ri-investimet e mundshme në pasuritë e paluajtshme të dhëna në përdorim, do të trajtohen si zhvillim i infrastrukturës për qëllime publike dhe do të jenë subjekt vendimarrje me përparësi, për veprimtari specifike dhe të veçantë, bazuar në Ligjin Nr. 10119, datë 23.04.2009 "Për planifikimin e territorit", i ndryshuar dhe akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij.
5. Autorizohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës të negociojë dhe përfundojë të gjitha marrëveshjet juridike, në zbatim të pikës 3 të këtij neni.

Për përcaktimin e vlerës së kapitalit themeltar të reformuar


1. Në zbatim të Nenit 4 të këtij vendimi, vlera e kapitalit themeltar të shoqërisë aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, do të jetë 104.000.000 (njëqind e katër milion) Lek.
2. Kapitali themeltar i reformuar i shoqërisë aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a përbëhet nga:
 - a) Kontributi në para i aksionarit Bashkia e Tiranës, sipas Vendimit nr. 3, datë 01.03.2012 të Këshillit Bashkiak, në vlerën 80.000.000 (tetëdhjetë milion) Lek;
 - b) Logo dhe emri i mirë i shoqërisë, në masën 30 % (tridhjetë përqind) të vlerës së kapitalit themeltar, në vlerën: 24.000.000 (njëzetë e katër milion) Lek.

Për konvertimin e detyrimeve dhe aksionet e reja

Të gjithë subjektet të cilët kanë nënshkruar marrëveshje sponsorizimi me Klubin e Futbollit Tirana dhe e kanë tejkalluar nivelin e sponsorizimit në para apo në natyrë të parashikuar në kontratat respektive, kanë të drejtë të përfitojnë konvertim të vlerave financiare në aksione të shoqërisë tregtare.

1. Për të përfituar nga e drejta e parashikuar në pikën 1 të këtij neni, subjektet janë të detyruara të paraqesin:
 - a) Kërkesë me shkrim drejtuar shoqërisë tregtare;
 - b) Marrëveshjen juridike ku të provohet tejkallimi i masës së sponsorizimit, për të cilën subjekti nuk ka përfituar lehtësirat fiskale përkatëse. Në kuptim të kësaj pike, do të kërkojë subjektin në vijim juridike të vlerësime, ato akte të cilat subjekti i interesuar ka nënshkruar me Klubin e Futbollit Tirana, në të dyja format juridike të saj dhe nga ku, do të rezultojë se Klubi pranon egzistencën e këtij detyrimi dhe rrethana e

Aplikant: Lorin BURBA



konvertimit të tij në aksione apo kontribut në kapitalin themeltar është parashikuar shprehimisht në të;

- c) Çdo dokument tjetër i cili mund të provojë se subjekti ka tejkaluar nivelin e sponsorizimit kontraktor.
2. Klubi i Futbollit Tirana sh.a është përgjegjëse për administrimin e të gjithë dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e interesuara dhe për kryerjen e verifikimeve të nevojshme për vërtetësinë e kërtimeve.
3. Autorizohet Kryetari i Bashkisë së Tiranës për vendimarrjen mbi konvertimin e detyrimeve në aksione, sipas dokumentacionit të paraqitur nga subjektet e interesuara.

Procedura e posaçme për konvertimin e aksioneve

1. Brenda 7 ditëve nga administrimi i dokumentacionit të paraqitur dhe nga kryerja e verifikimeve të nevojshme, Klubi i Futbollit Tirana sh.a i paraqet për miratim Kryetarit të Bashkisë kërkesën e subjekteve të interesuara për konvertimin e detyrimeve në aksione.
2. Kërkesa e paraqitur nga Klubi i Futbollit Tirana sh.a duhet të përmbajë:
 - a) Një përmbledhje të fakteve;
 - b) Vlerën e detyrimit të konvertueshëm në aksione;
 - c) Dokumentacionin mbi të cilin mbështetet ky detyrim;
 - d) Dokumentacionin e subjektit të interesuar;
 - e) Plan – zhvillimin e subjektit të interesuar;
 - f) Opinion ligjor mbi kategorizimin e detyrimit të konvertueshëm në aksione dhe procedurës së zbatueshme;
 - g) Vlerën e kapitalit themeltar të reformuar në rast miratimi të konvertimit të detyrimeve në aksione.
3. Brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës së Klubit të Futbollit Tirana sh.a, Kryetari i Bashkisë do të shprehet me vendim për pranimin ose mospranimin e saj.
4. Brenda 90 ditëve nga marrja e vendimit për pranimin e kërkesës së Klubit të Futbollit Tirana sh.a, Kryetari i Bashkisë njofton Këshillin Bashkiak për veprimin e kryer.
5. Në rast pranimi të kërkesës për konvertim të detyrimeve në aksione, vendimi bëhet i regjistrueshëm në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit menjëherë.
6. Ngarkohet Klubi i Futbollit Tirana sh.a për vënien në zbatim të këtij neni.
7. Në zbatim të Nenit 3 dhe 6 të këtij vendimi, autorizohet Kryetari i Bashkisë për përfundimin e marrëveshjeve për emetimin e aksioneve të reja të kapitalit themeltar të Klubit të Futbollit Tirana sh.a dhe për kalimin e të drejtave mbi to tek subjektet e interesuara.

Ndryshime, shfuqizime dhe të fundit

1. Në Nenin 6 të Statutit të Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, shfuqizohet paragrafi i dytë.
2. Në Nenin 28 të Statutit të Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, shfuqizohet paragrafi i dytë.

Aplikant: Lorin BURBA



Ndryshime

1. Në Statutin e Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, të shtohet Neni 13/1 me këtë përmbajtje:
“ 1.Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a i ushtron Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Tiranës, në cilësinë e aksionares së vetme.
2. Këshilli Bashkiak i Bashkisë së Tiranës do të ushtrojë të gjitha atributet e parashikuara në Nenin 13 të Statutit të Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, me përjashtim të pikave 8, 9, 10, të cilat i delegohen Kryetarit të Bashkisë të Tiranës.”
2. Në zbatim të Nenit 4 dhe 5 të këtij vendimi, Neni 7 i Statutit të Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, ndryshohet si vijon:
“ 1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 104.000.000 (njëqind e katër milion) Lek, korrespondues i 104.000 (njëqind e katërmijë) aksione, me vlerë nominale 1.000 Lek.
2. Bashkia e Tiranës është zotëruese e 100 % (njëqind përqind) e kapitalit themeltar të Klubit të Futbollit Tirana sh.a.”

Të fundit

1. Ngarkohen Klubi i Futbollit Tirana sh.a dhe Bashkia e Tiranës për vënien në zbatim të këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

KRYETARI

ALDRIN DALIPI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
KRYETARI

Nr. ____ Prot.

Datë ____/____/2014

Lënda: Vendim

V E N D I M
Nr 42385, datë 15.09.2014

Bazuar në Ligjin Nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar; Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar; Ligjin Nr. 9879, datë 21.02.2008 "Për titujt"; Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 për "Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar; Statutin e Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a; Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 18, datë 25.06.2014 "Për ndryshime në statutin, kapitalin themeltar dhe gjendjen juridike të Klubit të Futbollit Tirana sh.a",

VENDOSA:

1. Të njihet kontributi financiar i Shoqërisë "Halili" sh.p.k, tejkalues i vlerës së sponsorizimit kontraktor për Klubin e Futbollit Tirana, në masën: 202.300.000 (dyqind e dy milion e treqind mijë) Lek.
2. Të zmadhohet kapitali themeltar i Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a në vlerën: 202.300.000 (dyqind e dy milion e treqind mijë) Lek.
3. Zmadhimi i vlerës së kapitalit themeltar të kryhet përmes emetimit të aksioneve të reja, në masën 202.300 (dyqind e dy mijë e treqind) aksione me vlerën nominale 1.000 (një mijë) Lek.
4. Të konvertohet kontributi financiar i Shoqërisë "Halili" sh.p.k në aksione të kapitalit themeltar të Shoqërisë Aksionare Klubi i Futbollit Tirana sh.a, në masën 202.300 (dyqind e dy mijë e treqind) aksione me vlerën nominale 1.000 (një mijë) Lek.
5. Kontributet financiare të cilat konvertohen në aksione, sa i përket zmadhimit të kapitalit themeltar përmes emetimit të aksioneve të reja, do të konsiderohen të nënshkruara dhe të shlyera nga ana e Shoqërisë "Halili" sh.p.k.
6. Kapitali themeltar i reformuar pas emetimit të aksioneve të reja do të jetë 306.300.000 (treqind e gjashtë milion e treqind mijë) Lek, korrespondues i 306.300 (treqind e gjashtë mijë e treqind) aksioneve me vlerë nominale 1.000 Lek.

Aplikanti:
Lorin Burba

1

7. Ngarkohen ekspertët kontabël të miratuar të Klubit të Futbollit Tirana sh.a për hartimin e Raportit për përcaktimin e shpërndarjes së aksioneve ndërmjet personave juridik pjesëmarrës në kapitalin themeltar.
8. Autorizohet Administratori i Klubit të Futbollit Tirana sh.a të nënshkruajë marrëveshjen për kalimin e të drejtave mbi aksionet e shoqërisë, sa i përket parashikimeve të këtij vendimi.
9. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse për vënien në dijeni të këtij vendimi, Shoqërinë "Halili" sh.p.k dhe Klubin e Futbollit Tirana sh.a.
10. Shlyerja e debive të Klubit të Futbollit Tirana sh.a deri në datën e këtij akti do të kryhet në mënyrë të përbashkët nga aksionarët e shoqërisë, në varësi të kontributit në kapitalin themeltar.
11. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit Strategjik, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Klubi i Futbollit Tirana sh.a për hartimin e marrëveshjes për likuidimin e debive të shoqërisë ndërmjet aksionarëve.
12. Ngarkohen aksionarët e Klubit të Futbollit Tirana sh.a të shlyejnë detyrimet për paga ndaj subjekteve të cilët rezultojnë të punësuar nga shoqëria, brenda datës 31.12.2014.
13. Ngarkohet Klubi i Futbollit Tirana sh.a, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Planifikimit Strategjik për vënien në zbatim dhe regjistrimin e këtij vendimi pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
15. U shpall sot, më datë 15.09.2014.

KRYETARI

Lulzim BASHA

Aplikanti:
Lorin Burba

2